



**ALCRED**  
FOOD PROCESSING CO

# ALCRED FOOD PROCESSING CO SHPK

---

Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2016

INDIVIDUALE

## **PERMBAJTJA:**


1.	PASQYRA E SITUATES FINANCIARE .....	1
2.	PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE .....	3
3.	PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE.....	5
4.	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL .....	6
5.	INFORMACIONE TE PERGJITHESHME .....	7
6.	BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE .....	7
7.	GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME.....	7
8.	POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL.....	8
9.	MJETE MONETARE .....	12
10.	KERKESA TE ARKETUESHME.....	12
11.	KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME .....	13
12.	PARAPAGIME TE SHTYRA.....	13
13.	KERKESA TE ARKETUESHME AFATGJATA .....	13
14.	AKTIVE AFATGJATA MATERIALE .....	13
15.	AKTIVE TE TJERA AFATGJATA JO MATERIALE .....	14
16.	TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE.....	14
17.	TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE.....	14
18.	DETYRIME TATIMORE .....	15
19.	PARAPAGIME TE ARKETUARA.....	15
20.	KAPITALI AKSIONER.....	15
21.	TE ARDHURA TE TJERA NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT .....	16
22.	SHPENZIME TE TJERA NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT .....	16
23.	TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE .....	16
24.	SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN .....	16
25.	PALET E LIDHURA.....	17
26.	NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT .....	17

**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**PASQYRA FINANCIARE VITI 2016**

(Vlerat ne ALL)

**1. PASQYRA E SITUATES FINANCIARE**

1. Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) 31 Dhjetor 2016		në lekë	
	Zëri i Bilancit	2016	2015
<b>A</b>	<b>AKTIVET</b>	<b>1,068,270,997</b>	<b>1,119,718,968.75</b>
<b>1</b>	<b>Aktivët Afatshkurtra</b>	<b>101,017,870</b>	<b>108,474,317.39</b>
<b>1</b>	<b>Mjete monetare</b>	<b>17,029,338</b>	<b>15,379,028.47</b>
<b>2</b>	<b>Investime :</b>	-	-
a)	<i>Në tituj pronësie të njësjve ekonomike brenda grupit</i>		
b)	<i>Aksionet e veta</i>		
c)	<i>Të tjera financiare</i>		
	<b>Totali</b>	-	-
<b>3</b>	<b>Të drejta të arkëtueshme :</b>	<b>77,552,127</b>	<b>85,523,047.95</b>
a)	<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	73,255,971	73,251,508.06
b)	<i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>		
c)	<i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
d)	<i>Të tjera</i>	4,296,156	12,271,539.89
e)	<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>		
	<b>Totali</b>	<b>77,552,127</b>	<b>85,523,047.95</b>
<b>4</b>	<b>Inventarët:</b>	-	-
<b>5</b>	<b>Shpenzime të shtyra</b>	<b>6,436,405</b>	<b>7,572,240.97</b>
<b>6</b>	<b>Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara</b>		
	<b>I-Aktive totale afatshkurtra</b>	<b>101,017,870</b>	<b>108,474,317.39</b>
<b>II</b>	<b>Aktive Afatgjata</b>	<b>967,253,127</b>	<b>1,011,244,651.36</b>
<b>1</b>	<b>Aktive financiare:</b>	<b>805,046,886</b>	<b>791,413,017.48</b>
a)	<i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit</i>		
b)	<i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit</i>		
c)	<i>Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
d)	<i>Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
e)	<i>Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata</i>		
f)	<i>Tituj të tjerë të huadhënies</i>	805,046,886	791,413,017.48
	<b>Totali</b>	<b>805,046,886</b>	<b>791,413,017.48</b>
<b>2</b>	<b>Aktivët materiale:</b>	<b>161,755,697</b>	<b>219,301,581.88</b>
a)	<i>Toka dhe ndërtesa</i>	161,704,522	219,233,347.88
b)	<i>Impiante dhe makineri</i>		
c)	<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	51,175	68,234.00
d)	<i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>		
	<b>Totali</b>	<b>161,755,697</b>	<b>219,301,581.88</b>
<b>3</b>	<b>Aktive Biologjike</b>		
<b>4</b>	<b>Aktive jo materiale:</b>	<b>450,544</b>	<b>530,052.00</b>
a)	<i>Koncesione, patenta, liçenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme</i>	450,544	530,052.00
b)	<i>Emri i Mirë</i>		
c)	<i>Parapagime për AAJM</i>		
	<b>Totali</b>	<b>450,544</b>	<b>530,052.00</b>
<b>5</b>	<b>Aktive tatimore të shtyra</b>		
	<b>II-Aktive totale afatgjata</b>	<b>967,253,127</b>	<b>1,011,244,651.36</b>
	<b>Aktive totale (I+II)</b>	<b>1,068,270,997</b>	<b>1,119,718,968.75</b>



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**PASQYRA FINANCIARE VITI 2016**

(Vlerat ne ALL)

1. Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci) 31 Dhjetor 2016		në lekë	
	Zëri i Bilancit	2,016	2,015
<b>B</b>	<b>DETYRIME DHE KAPITALI</b>	<b>1,068,270,997</b>	<b>1,119,718,969</b>
<b>I</b>	<b>Detyrimet afatshkurtra</b>	<b>121,160,001</b>	<b>183,213,414</b>
<b>1</b>	<b>Detyrime afatshkurtra:</b>	<b>121,160,001</b>	<b>183,213,414</b>
a)	<i>Titujt e huamarrjes</i>		
b)	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>		
c)	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>	119,426,055	181,453,860
d)	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	88,269	84,369
e)	<i>Dëftesa të pagueshme</i>		
f)	<i>Të pagueshme ndaj njërive ekonomike brenda grupit</i>		
g)	<i>Të pagueshme ndaj njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
h)	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	984,559	962,119
i)	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	1,118	53,066
j)	<i>Të tjera të pagueshme</i>	660,000	660,000
	<b>Totali</b>	<b>121,160,001</b>	<b>183,213,414</b>
<b>2</b>	<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>		
<b>3</b>	<b>Të ardhura të shtyra</b>	-	-
<b>4</b>	<b>Provizione</b>		
	<b>I-Totali i Detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>121,160,001</b>	<b>183,213,414</b>
<b>II</b>	<b>Detyrime afatgjata</b>	-	-
<b>1</b>	<b>Detyrime afatgjata:</b>	-	-
	<b>Totali</b>	-	-
<b>2</b>	<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>		
<b>3</b>	<b>Të ardhura të shtyra</b>		
<b>4</b>	<b>Provizione:</b>	-	-
	<b>Totali</b>	-	-
<b>5</b>	<b>Detyrime tatimore të shtyra</b>		
	<b>II-Totali i Detyrimeve afatgjata</b>	-	-
	<b>Detyrime totale(I+II)</b>	<b>121,160,001</b>	<b>183,213,414</b>
<b>III</b>	<b>Kapitali dhe Rezervat</b>	<b>947,110,996</b>	<b>936,505,555</b>
<b>1</b>	<b>Kapitali i Nënshkruar</b>	<b>906,928,519</b>	<b>906,928,519</b>
<b>2</b>	<b>Primi i lidhur me kapitalin</b>		
<b>3</b>	<b>Rezerva rivlerësimi</b>		
<b>4</b>	<b>Rezerva të tjera</b>	<b>135,205</b>	<b>135,205</b>
a)	<i>Rezerva ligjore</i>	135,205	135,205
b)	<i>Rezerva statutore</i>		
c)	<i>Rezerva të tjera</i>		
<b>5</b>	<b>Fitimi i pashpërndarë</b>	-	-
<b>6</b>	<b>Fitim / Humbja e Vitit</b>	<b>40,047,272</b>	<b>29,441,831</b>
	<b>III-Totali i Kapitalit</b>	<b>947,110,996</b>	<b>936,505,555</b>
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>	<b>1,068,270,997</b>	<b>1,119,718,969</b>



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**PASQYRA FINANCIARE VITI 2016**

(Vlerat ne ALL)

**2. PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE**

`` Alcred`` sh.p.k. 31.12.2016

2.a2.Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse				
				në lekë
N.r.	P Ë R S H K R I M I	Shenime	2016	2015
1	Fitimi/Humbja e vitit		40,047,272.16	29,441,831.41
2	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
a)	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja			
b)	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
c)	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje			
d)	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet			
	<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		-	-
3	<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		40,047,272.16	29,441,831.41
4	<b>Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:</b>			
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		40,047,272.16	29,441,831.41
	Interesat jo-kontrolluese			



ALCRED FOOD PROCESSING CO  
PASQYRA FINANCIARE VITI 2016

(Vlerat ne ALL)

Alcred sh.p.k. 31.12.2016

2.a1. Pasqyra e Performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Formati I – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës			në lekë	
N.r.	P E R S H K R I M I	Shenime	2016	2015
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit			
2	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme			
3	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e			
4	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		114,527,747.05	103,589,853.15
5	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
a)	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme			
b)	Të tjera shpenzime			
6	Shpenzime të personelit		(1,316,730.00)	(3,250,866.00)
a)	Paga dhe shpërblyme		(1,228,279.00)	(2,971,438.00)
b)	Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(88,451.00)	(279,428.00)
c)				
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi		(1,232,403.00)	(1,452,562.00)
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi		(64,025,246.99)	(61,280,442.84)
10	Të ardhura të tjera		-	-
a)	Të ardhura nga njësia ekonomike ku ka interesa			
b)	Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e			
c)	Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të			
d)	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve			
12	Shpenzime financiare		135,463.79	(1,233,909.99)
a)	Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		270.83	791.71
b)	Shpenzime të tjera financiare			
c)	Fitimet (humbjet) nga këmbimet valutare		135,192.96	(1,234,701.70)
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
	<b>Fitimi/Humbja para tatimit</b>		<b>48,088,830.85</b>	<b>36,372,072.32</b>
14	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(8,041,558.69)	(6,930,240.91)
a)	Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(8,041,558.69)	(6,930,240.91)
b)	Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë			
c)	Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve			
	<b>Fitimi/Humbja e vitit</b>		<b>40,047,272.16</b>	<b>29,441,831.41</b>
	<b>Fitimi/Humbja për:</b>			
	Pronarët e njësive ekonomike mëme		40,047,272.16	29,441,831.41
	Interesat jo-kontrolluese		-	-

Gledis NGJELINA

GLEDIS NGJELINA

Administratori

**ALCRED sh.p.k**  
J B 1426006 C  
TIRANE - ALBANIA



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**PASQYRA FINANCIARE VITI 2016**

(Vlerat ne ALL)

**3. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE<sup>1</sup>**

“ Alcred ” sh.p.k. 31.12.2016

3. Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare			në lekë	
Sipas metodës direkte . Direct method			2016	2015
N.r.	P Ë R S H K R I M I	Shenime		
<b>A</b>	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>			
1	Të arkëtuara nga të drejtat e arkëtueshme		110,000,635.40	419,604,460.43
2	Të paguara për detyrimet e pagueshme dhe detyrimet		(143,464,128.69)	(158,969,965.05)
3	Pagesa të tjera			
4	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
	<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti i</b>		<b>(33,463,493.29)</b>	<b>260,634,495.37</b>
5	Interesi i paguar - Interest paid			
6	Tatim fitimi i paguar - Taxtion paid		6,930,241.00	(16,950,942.00)
	<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e</b>		<b>(26,533,252.29)</b>	<b>243,683,553.37</b>
<b>B</b>	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në)</b>			
1	Para neto të përdorura për blerjen e filialeve		-	-
2	Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve			
3	Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale			
4	Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		57,625,392.94	53,987,548.00
5	Pagesa për blerjen e investimeve të tjera			
6	Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera			
7	Dividentë të arkëtuara - Dividends received			
8				
	<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e</b>		<b>57,625,392.94</b>	<b>53,987,548.00</b>
<b>C</b>	<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në)</b>			
1	Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		-	-
2	Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si			
3	Hua të arkëtuara			
4	Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë			
5	Riblerje e aksioneve të veta			
6	Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral			
7	Pagesa e huave			
8	Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare			
9	Interesi i paguar - Interest paid			
10	Dividendë të paguar - Dividends paid		(29,441,831.05)	(292,749,437.79)
	<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e</b>		<b>(29,441,831.05)</b>	<b>(292,749,437.79)</b>
	<b>Kritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>		<b>1,650,309.60</b>	<b>4,921,663.58</b>
	<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve</b>		<b>15,379,028.47</b>	<b>10,457,364.89</b>
8	Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve			
	<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve</b>	9	<b>17,029,338.07</b>	<b>15,379,028.47</b>

<sup>1</sup> Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare është përgatitur sipas metodës direkte.

4. Pasqyra e Ndërvënimeve në Kapitalin Neto për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2016 në një pasqyrë individuale të paktosoliduar

	në lekë									
	Kapitali i nënshkruar	Prindësit Lidhur me Rritje kapitalit rëtimin	Rezerva Ligjore	Rezerva Statutore	Rezerva të tjera	Fittimet e Pashpërndara	Fitim / Humbje e vlerë	Totali	Interesa Jo-Kontrolues	Totali
<b>PER SH K RIMI</b>										
<b>pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2013</b>	906,928,519.00		135,205.00			(65,936,287.04)	244,257,967.79	1,085,385,404.75		1,085,385,404.75
Efekte i ndërvënimeve në politikat kontabël										
<b>pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2014</b>	906,928,519.00		135,205.00			(65,936,287.04)	244,257,967.79	1,085,385,404.75		1,085,385,404.75
Te ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin						244,257,967.79	(244,257,967.79)			
Fitim / Humbje e vlerë ushtrimit							114,427,757.04	114,427,757.04		114,427,757.04
Fitim / Humbje e vlerë ushtrimit										
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse										
<b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin</b>										
Transaksionet me pronarët e rrysisë ekonomike të rjohur direkt në kapital:										
Emetimi i kapitalit të re-shkruar										
Dividendë të paguar										
Totali i transaksioneve me pronarët e rrysisë ekonomike										
<b>pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2014</b>	906,928,519.00		135,205.00			178,321,680.75	114,427,757.04	1,199,813,161.80		1,199,813,161.80
<b>pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015</b>	906,928,519.00		135,205.00			178,321,680.75	114,427,757.04	1,199,813,161.80		1,199,813,161.80
Te ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin										
Fitim / Humbje e vlerë të mepartshëm							29,441,831.14	29,441,831.14		29,441,831.14
Fitim / Humbje e vlerë ushtrimit										
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse										
<b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin</b>										
Transaksionet me pronarët e rrysisë ekonomike të rjohur direkt në kapital:										
Emetimi i kapitalit të re-shkruar										
Dividendë të paguar										
Totali i transaksioneve me pronarët e rrysisë ekonomike						(178,321,680.75)	(114,427,757.04)	(292,749,437.80)		(292,749,437.80)
<b>pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015</b>	906,928,519.00		135,205.00				29,441,831.14	936,505,555.14		936,505,555.14
<b>pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016</b>	906,928,519.00		135,205.00				29,441,831.14	936,505,555.14		936,505,555.14
Te ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin										
Fitim / Humbje e vlerë të mepartshëm										
Fitim / Humbje e vlerë ushtrimit							40,047,272.16	40,047,272.16		40,047,272.16
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse										
<b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin</b>										
Transaksionet me pronarët e rrysisë ekonomike të rjohur direkt në kapital:										
Emetimi i kapitalit të re-shkruar										
Dividendë të paguar										
Totali i transaksioneve me pronarët e rrysisë ekonomike							(29,441,831.14)	(29,441,831.14)		(29,441,831.14)
<b>pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016</b>	906,928,519.00		135,205.00				40,047,272.16	947,110,996.16		947,110,996.16
<b>pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017</b>	906,928,519.00		135,205.00				40,047,272.16	947,110,996.16		947,110,996.16





**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

*(Vlerat ne ALL)*

**5. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME**

Shoqeria "Alcred Food Processing Co" sh.p.k. është themeluar me datë 10 Shkurt 1998 me Vendim te Gjykates se Shkalles Pare Tirane Nr. 18719 dhe eshte regjistruar ne regjistrin e shoqerive tregtare ne te njejten dite. Me date 09 Korrik 2007 shoqeria u ble nga Neptun sh.p.k, e cila eshte pjese e grupit Balfin. Me pas ne muajin Nentor 2011 shoqeria u ble 100% nga Balfin shpk e cila eshte edhe aktualisht ortaku i vetem i shoqerise. Kapitali i nenshkruar eshte 906,928,519 Leke.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte shitja, blerja dhe dhenie me qira e pasurive te paluajtshme, si edhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Certifikimi tatimor:** NIPT J81426006C

**Forma juridike e shoqerise:** Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

**Adresa e selise :** Komuna Kashar, Rruga "Tre deshmoret", Tirane

**Numri i punonjesve:** Me date 31 Dhjetor 2016 shoqeria ka 1 punonjes.

Administrator i emeruar i shoqerise eshte z. Gledis NGJELINA.

**6. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE**

Shoqeria i mban te dhenat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare te vitit 2016 ne bazë të Standardeve Kombëtare të Raportimit Financiar ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon Shoqëria. Shifrat janë të rrumbullakosura në Lekë.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuar dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t'i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpjekje për t'i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuar në pasqyrën e te ardhurave gjithpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

**7. GJYKIMET, VLERSIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që Drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.


Vleresimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhshme, në të cilën ato ndikojnë. Informacioni mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë paraqitur më poshtë.

***Përcaktimi i vlerës së drejtë***

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël të adoptura nga Shoqëria të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të informacioneve shpjeguese të bazuara në metodat e mëposhtme. Kur janë të aplikueshme, informacione rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqiten në shënimet specifike të aktiveve ose detyrimeve.

***Tatimi mbi fitimin***

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë. Shoqëria njeh detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

*(Vlerat ne ALL)*

rëndësishme me shumt të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktual dhe të shtyrë dhe detyrimet në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë

**8. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL**

**(a) Transaksionet në monedhë të huaj**

Rregjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit që është kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2016, 1 Euro me 135,23 Lekë dhe 1 USD me 128,17 Lekë.

Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të regjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monedhë të huaj.

**(b) Instrumentat financiare**

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'rregjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivitetit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlerë neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera

*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet tre mujor ose me pak. Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përbehen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra të percaktuara me lart, pasi i zbritet teprica e paradhënies bankare.

*Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi

*Huamarrjet dhe parapagimet*

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

*(Vlerat ne ALL)*

e cila skonton ekzaktesisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër..

*Llogaritëe pagueshme*

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit

*Te tjera*

Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interesit efektive, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet. *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

**(c) Aktivët Afatgjatë investimi**

Aktive afatgjatë investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qeratë dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet afatgjatë investimi maten me modelin e koston. Aktivët afatgjatë investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrin shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivitetit në kushtet për tu dhënë me qera.

**(d) Aktive afatgjatë materiale**

*Njohja dhe matja*

Aktivet afatgjatë materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmblendhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monedhë të huaj të aktiveve afatgjatë materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivet afatgjatë materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjatë materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitetit afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

*Kostot ne vijim*

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivitetit afatgjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivitetit në rast se është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

*Amortizimi*

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitetit ose çdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilën kategori asetesh:

a) Ndërtesa	5%
b) Makineri e Paisje	20%
c) Mjete transporti	20%
d) Paisje informatike	25%



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

*(Vlerat ne ALL)*

Kjo mënyrë pasqyron më përfaqësis trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivet në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

**(e) Aktive afatgjata jomateriale**

*Njohja dhe matja*

Aktivitet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

*Kostot ne vijim*

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

*Amortizimi*

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur me një normë vjetore amortizimi 25% për pajisjet informatike dhe 20% për pajisjet dhe aktivet e tjera.

**(f) Zhvlerësimi**

*Aktivitet financiare*

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitet, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitet të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivitet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

*Aktivitet jo financiare*

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skontoohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitet ose e njësisve të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

**(g) Perfitimet e punonjesve**

*Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*

Gjatë ecuresë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

*Pensioni i detyrueshëm*



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

*(Vlerat ne ALL)*

Shoqëria, gjate aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontribuar ne planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

*Leja e zakonshme e paguar*

Shoqëria njih si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

**(h) Provigjonet**

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

**(i) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

**(j) Të ardhurat nga qeratë**

Të ardhurat nga qeraja janë të ardhura të përfituara nga kontratat e qerasë, përveç të ardhurave të kushtëzuara të qerasë të cilat njihen kur përfitohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin gjatë negociimit të një kontrate qeraje njihen si shpenzime në termat e qerasë me të njëjtat baza sit ë ardhurat nga qeraja.

Përpjekjet për të nënshkruar një kontratë qeraje janë shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë afatit të kontratës së qerasë edhe nëse këto pagesa nuk bëhen në këto baza. Afati i qerasë është një periudhë e pa anulueshme qeraje së bashku me afate të tjera të mëtejshme për të cilat qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, kur, në fillim të qerasë drejtimi ka një siguri të arsyeshme që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

Shumat e marra nga qeramarrësi për përfundimin e qerasë ose kompesimin e përfundimit të saj njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse kur lind e drejta për ti marrë ato..

**(k) Pagesat per qeranë financiare**

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në menyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

*Depozitimet e qeramarrësit*

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten më kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

**(l) Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.


Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

**(m) Kostot e huamarrjes**

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen koston së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet koston së aktivitetit.



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

(Vlerat ne ALL)

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

**(n) Taksat**

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

**(o) Ngjarjet pas datës së bilancit**

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorigjueshme.

**9. MJETE MONETARE**

Posti Mjete Monetare perfshihen gjendjen e likuiditetit te shoqerise me date 31 Dhjetor 2014, ne llogarite rrjedhese prane bankave te nivelit te dyte dhe mjeteve monetare cash. Per njohjen fillestare te ketyre elementeve si dhe per gjendjet, eshte perdorur politika kontabel e "vleres se drejte"


Mjete Monetare	31 Dhjetor 2016	30 Dhjetor 2015
<b>I. Para ne dore</b>	<b>90,430</b>	<b>203,716</b>
Ne monedhe vendase	15,887	129,172
Ne monedhe te huaj	74,543	74,543
<b>II. Llogari ne banke</b>	<b>16,938,908</b>	<b>15,175,313</b>
Ne monedhe vendase	8,078,888	707,991
Ne monedhe te huaj	8,860,020	14,467,322
<b>Depozite afatshkurter</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Total mjete monetare (I+II)</b>	<b>17,029,338</b>	<b>15,379,028</b>

**10. LLOGARI / KERKESA TE ARKETUESHME**

Posti Llogari kerkesa te arketueshme perbehet si me poshte:

**Llogari kerkesa te arketueshme**

	31 Dhjetor 2016	30 Dhjetor 2015
Food way	21,882,000	21,882,000
Skenderbej	49,400,501	49,400,501
The point	-	-
S.P Albinpex	-	-
Te tjere	1,973,470	1,969,007
<b>Totali</b>	<b>73,255,971</b>	<b>73,251,508</b>



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

(Vlerat ne ALL)

**11. LLOGARI / KERKESA TE TJERA TE ARKETUESHME**

Posti Llogari/ kerkesa te tjera te arketueshme perbehet si me poshte:

<b>Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>30 Dhjetor 2015</b>
Tatim Fitimi	3,410,933	11,452,491
TVSH e rimbursueshme	819,048	819,048
Sigurime Shoqerore	66,175	
<b>Totali</b>	<b>4,296,156</b>	<b>12,271,540</b>

Ne kete ze eshte perfshire e drejta tatimore qe ka shoqeria per TVSH e rimbursueshme, per Tatim Fitimin, sigurimet shoqerore .

**12. PARAPAGIME TE SHTYRA**

Posti parapagime te Shtyra perbehet si me poshte:

<b>Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>30 Dhjetor 2015</b>
Shpenzime te periudhave te ardhshme	6,436,405	7,572,241
<b>Totali</b>	<b>6,436,405</b>	<b>7,572,241</b>

Ky ze paraqet shpenzime te shoqerise te cilat i takojne me shume se nje periudhe tatimore.

**13. LLOGARI / KERKESA TE ARKETUESHME AFATGJATA**

Posti Llogari/Kërkesa të Arkëtueshme Afatgjata përbëhet si më poshtë:

<b>Llogari / Kërkesa te arkëtueshme afatgjata</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>30 Dhjetor 2015</b>
Balfin	754,173,464	740,539,595
Mane TCI	12,374,800	12,374,800
Neptun	38,498,622	38,498,622
<b>Totali</b>	<b>805,046,886</b>	<b>791,413,017</b>


Ne kete ze perfshihen kontributet ne vlere monetare te Shoqerise Alcred Food Processing Co per ortakun e tij te vetem Balfin, sipas nevojave financiare qe ka patur shoqeria gjate vitit financiar 2016. Duke pasur parasysh gjendjen e likuiditetit si dhe performancen financiare te seciles shoqeri, Alcred do te vendose gjate viteve ne vazhdim per kthimin e fondeve.

Gjithashtu jane te paraqitura edhe detyrimet qe kane shoqerite Neptun dhe Mane TCI ndaj shoqerise Alcred te cilat pritet te arketohen ne vitin ne vazhdim.

**14. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mëposhtme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit Dhjetor 2016.

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë vit ushtrimor kontabël, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

(Vlerat ne ALL)

Metodat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë të njëjta me ato që përdoren për qëllime fiskale. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur për efekte fiskale.

Aktive Afatgjata Materiale	Toka	Paisje zyre dhe informatike
<b>Balanca ne 01 Janar 2016</b>	<b>219,233,348</b>	<b>158,408</b>
Shtesa	-	-
Pakesime	(57,528,826)	-
<b>Balanca ne 31 Dhjetor 2016</b>	<b>161,704,522</b>	<b>158,408</b>
<b>Amortizimi</b>		(107,233)
Ndryshimi deri ne vitin 2015	-	-
<b>Vlera e mbetur ne 31 Dhjetor 2016</b>	<b>161,704,522</b>	<b>51,175</b>

**15. AKTIVE TE TJERA AFATGJATA JO MATERIALE**

Posti Aktive te tjera Afatgjata jo materiale perbehet si me poshte:

**Shpenzimet e Zhvillimit**

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>30 Dhjetor 2015</u>
Shpenzime per nisje dhe zgjerim	450,544	530,052
<b>Totali</b>	<b>450,544</b>	<b>530,052</b>

Ky ze paraqet shpenzime per nisje dhe zgjerim qe ka kryer shoqeria ne fillim te aktivitetit te saj. Keto shpenzime jane amortizuar me nje norme vjetore prej 15%.

**16. TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE**

Posti Te pagueshme ndaj furnitoreve perbehet si me poshte:

**Te pagueshme ndaj furnitoreve**

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>30 Dhjetor 2015</u>
Diezela	70,429	70,429
Eva Blushi	7,600	7,600
Sonila Bejtja	3,800	2,500
2AS	3,840	3,840
Marinela Bode	2,600	
	88,269	84,369
<b>Totali</b>	<b>88,269</b>	<b>84,369</b>

Ne kete grup jane perfshire detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve. Ne njohjen fillestare zerat e ketij grupi jane vleresuar me kosto. Ne vijim te njohjes fillestare, huate dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur cdo diference midis koston dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

**17. TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE**

Posti Te pagueshme ndaj Punonjesve perbehet si me poshte:





**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

(Vlerat ne ALL)

Te pagueshme ndaj punonjes ve	31 Dhjetor 2016	30 Dhjetor 2015
Paga dhe shperblime per tu paguar	984,559	962,119
<b>Totali</b>	<b>984,559</b>	<b>962,119</b>

Ky ze perfaqeson pagat e administratorit te cilat do te likujdohen ne vazhdim te vitit 2017.

**18. DETYRIME TATIMORE**

Posti Detyrime Tatimore perbehet si me poshte:

Detyrimet tatimore	31 Dhjetor 2016	30 Dhjetor 2015
Sigurime Shoqerore dhe shendetsore	1,040	31,463
Tatim mbi te ardhurat personale	78	21,603
<b>Totali</b>	<b>1,118</b>	<b>53,066</b>

Detyrimet per Sigurimet shoqerore dhe shendestose dhe per Tatimin mbi te ardhurat Personale i perkasin muajit Dhjetor 2016 dhe jane likujduar me date 20 Janar 2017.

**19. PARAPAGIME TE ARKETUARA**

Posti parapagime te arketuara perbehet si me poshte:


Parapagime te arketuara	31 Dhjetor 2016	30 Dhjetor 2015
Parapagime te arketuara	120,086,055	182,113,860
<b>Totali</b>	<b>120,086,055</b>	<b>182,113,860</b>

Ky ze paraqet te gjitha arketimet e kryera nga klientet per blerjen e apartamenteve, dyqaneve dhe garazheve sipas keshteve te paracaktuara ne kontratat e premtim shitjes. Te gjitha arketimet e kryera reflektohen ne kete ze dhe ne momentin qe per njesite e shitura behet njohja e te ardhurave, kjo vlere kalon ne te ardhura te periudhes ushtrimore.

**20. KAPITALI AKSIONER**

Kapitali i shoqerise perbehet nga kuotat e kapitalit, te cilat jane njohur me vleren nominale. Ne menyre te pmbledhur, te dhenat per zoteruesit e kapitalit, numrin e kuotave dhe % e zoterimit, paraqiten ne tabelen e meposhtme:

Nr.	Zoterues te kapitalit	KAPITALI I AKSIONERVE			
		Date 31.12.2016			
		Nr. i kuotave	Vlera nominale ne Lek	Vlera totale e kapitalit ne Leke	Struktura ne %
1	Balfin Shpk	100	9,069,285	906,928,519	100%
	<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>9,069,285</b>	<b>906,928,519</b>	<b>100 %</b>



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

(Vlerat ne ALL)

**21. TE ARDHURA TE TJERA NGA VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT**

Posti Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit perbehet si me poshte:

**Parapagime te arketuara**

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>30 Dhjetor 2015</b>
Parapagime te arketuara	120,086,055	182,113,860
<b>Totali</b>	<b>120,086,055</b>	<b>182,113,860</b>

Ne kete ze jane perfshire te ardhurat nga shitja e apartamenteve, dyqaneve dhe garazheve. Ky ze perfshin te ardhurat nga njesite e shitura per klientet te cilet kane marre celsat dhe gezojne te drejten e shfrytezimit te njesive te tyre si edhe kane likujduar detyrimin e tyre ndaj shoqerise.

**22. SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT**

Posti Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit perbehet si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>30 Dhjetor 2015</b>
Kosto takuese e njesive te shitura	57,528,826	53,871,264
Te ndryshme	1,558,762	525,600
Te tjera tatime e taksa	389,200	279,370
Sherbime bankare	34,672	59,447
Shpenzime noteriale ligjore	56,000	-
Shpz.postare e telekom.	-	78,828
<b>Total</b>	<b>59,567,460</b>	<b>54,814,509</b>

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet e tjera te veprimtarise, te klasifikuara sipas natyres, jane paraqitur si me lart.

**23. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE**


Posti Te ardhura dhe Shpenzime Financiare perfaqeson fitime/humbje nga shkembimet valutore dhe te ardhura nga interesa te detajuara si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>30 Dhjetor 2015</b>
Fitimi nga kembimet valutore	135,193	19,255
Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore	-	(1,253,956)
Te ardhura dhe shpenzime nga interesi	271	792
<b>Total</b>	<b>135,464</b>	<b>(1,233,910)</b>

**24. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN**

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur per vitin ushtrimor 2016 bazohet ne detyrimin per tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal ne Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per vitin 2016 eshte 15%. Niveli taksimit per fitimin zbatuar ne vitin paraardhes 2015 ka qene 15%. Ne vlere nominale, tatim fitimi i llogaritur per vitin ushtrimor eshte **8,041,559 Lekë**. Per vitin ushtrimor shoqëria rezulton me një fitim neto të realizuar në vleren **40,047,272 Lekë**.

Më poshtë jepet detajimi i llogaritjes së tatim fitimit:



**ALCRED FOOD PROCESSING CO**  
**SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**  
**VITI 2016**

*(Vlerat ne ALL)*

	<b>31 Dhjetor 2016</b>	<b>30 Dhjetor 2015</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>48,088,831</b>	<b>36,372,072</b>
<b>Shpenzime te pazbritshme</b>	<b>5,521,560</b>	<b>9,829,534</b>
Sherbime per makinen	-	-
Te tjera shpz. rjedhese	-	-
<b>Fitimi tatimor i ushtrimit</b>	<b>53,610,391</b>	<b>46,201,606</b>
Humbje te mbartura	-	-
<b>Fitimi i tatueshem i ushtrimit</b>	<b>53,610,391</b>	<b>46,201,606</b>
<b>Tatim fitimi</b>	<b>8,041,559</b>	<b>6,930,241</b>

**25. PALET E LIDHURA**

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me shoqërinë mëmë (Balfin sh.p.k) dhe kompanitë e saj. Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut.

**26. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT**

Pas datës së bilancit kontabël nuk kanë ndodhur ngjarje që kane ndikuar në rezultatin financiar të vitit ushtrimor.

